



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1134/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore - bërja e fushatës përmes rrjetit social Facebook, për raundin e Dytë për Zgjedhjeve Lokale, të mbajtura me datë 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 15.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** e pabazuara ankesa Anr.1134/2021, e datës 14.11.2021, të parashtruara nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të sanksionohet, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore - bërja e fushatës përmes rrjetit social Facebook, për raundin e Dytë për Zgjedhjeve Lokale, të mbajtura me datë 14.11.2021.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar më datë 14.11.2021 ankesën Anr.1134/2021 nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se më datë 14 nëntor 2021, aktivistët e subjektit të tyre rreth orës 15:00 kanë vërejtur se mbështetësi i LVV-së, z.Kushtrim M.Ibrahimi ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), për të cilën në afatin paraparë ligjor parashtrojn ankesë. Më tutje në ankesë theksojnë se i njëjti ka shkruar këtë status në rrjetin social facebook: *“Mos prito dil e voto! I vote 4 minuta 4 vite” me ç’rast ka bërë thirrje për votim dhe ka formësuar numrin e kësaj partie 144, dhe me këtë veprim siç pretendohjnë ankesë janë në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b e LZP-së.*

Më tej parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i, që subjekti politik LVV, të sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.

Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës ka bashkangjitur tri fotografi të printuara nga rrjeti social-Facebook të aktivistit nga Subjekti Politik LVV, Kushtrim.M.Ibrahimi

Në përgjigjet në ankesë të subjektit politik LVV, theksohet se kjo ankesë është e paqëndrueshme për faktin se fotografitë e bashkangjitura si provë nuk është shkruar numri 144. Në vazhdim të përgjigjes theksohet se në asnjë mënyrë nuk janë të vërteta pretendimet e ankuesit se është bërë thirrje që të votohet Subjekti Politik LVV dhe në bazë të fotografive të bashkangjitura shieht qartë se nuk ka thirrje të tillë dhe këto pretendime siç theksojnë në përgjigje janë të paqëndrueshme.

PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale dhe fotografive të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve për ankesën, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse edhe pse barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka thyer heshtjen zgjedhore duke vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore duke bërë thirrje për të votuar edhe gjatë heshtjes zgjedhore, gjatë ditës së votimit edhe më datën 14.11.2021.

Paneli vjen në përfundim se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruesit të ankesës se kemi të bëjmë në këtë rast me thyerjen e heshtjes zgjedhore, sepse nga fotografitë e ofruara nuk shihet llogo e as numri 144 i Subjektit Politik LVV, ndërsa sipas dispozitës ligjore të nenit 36 paragrafi 1 i LZP-se pika b): *“Njëzet e katër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*, e për rastin konkret postimi lëndor në rrjetin social facebook nuk ka të bëjë me thirrje për të votuar apo bërje fushatë në çfarëdo mënyre. Për ti vlerësuar edhe më tej pretendimet ankimore, Paneli e ka verifikuar postimin lëndor dhe ka konstatuar se postimi në fjalë ende është aktiv te mbështetësi i LVV-së, por përveç shkrimit *“Mos prito dil e voto! Ivote 4 minuta 4 vite”* që është publikuar në heshtja zgjedhore, ditën e votimit siç është konstatuar më lart, nuk ka elemente me të cilën mund të


vërtetohet se për cilin subjekt apo kandidat ka bërë thirrje për të votuar, ky postim nuk është i sponsorizuar si reklamë që të shfaqet në vazhdimësi-automatiksht edhe gjatë heshtjes zgjedhore e poashtu i njëjti postim nuk ka prova në shkresat e lëndës lidhur me pretendimet në fjalë.

Andaj, nisur nga arsyet e cekura më lartë, PZAP-i ka gjetur se nuk ka pasur thyerje të heshtjes zgjedhore pasi që në postimin në fjalë nuk ka reklamim të asnjë subjekti politik, por vetëm në mënyrë të përgjithshme është bërë thirrje për të votuar nga gjithë qytetarët.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa**  
Anr.1134/2021 më datë 15.11.2021

**Kryesues i Panelit**  
Ferki Xhaferi



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.